



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800754/11

Tiranë ___/___/2019

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për ekzekutimin e detyrimit të vendosur nga gjykata sipas vendimit Nr.632, datë 07.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë, Tiranë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 3510, datë 27.10.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, në favor të shtetasit N.P.*

Drejtuar : **Z. Ardian Kamenica**
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

TIRANË

I nderuar Z. Kamenica,

Sikurse jeni në dijeni, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësi N.P, i cili ankohet ndaj institucionit tuaj për moszekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr.632, datë 07.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Konkretisht, ankuesi ka qenë i punësuar në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Korçë me detyrë Inspektor-Jurist dhe me urdhërin tuaj nr. 1344/11 prot., datë 21.02.2014, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me të. Duke e konsideruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës të padrejtë, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Korçë me kërkesë-padi, duke kërkuar dëmshpërblimet përkatëse, sipas ligjit. Kjo gjykatë, me vendimin Nr.632, datë 07.11.2014, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesës padisë, duke i njohur ankuesit dhe shpërblimet përkatëse:

- Dy muaj pagë neto për mosrespektim të afatit të njoftimit, sipas nenit 143/1 të Kodit të Punës;
- Dy muaj pagë neto për mosreapektim të procedurës, sipas nenit 144 të Kodit të Punës;
- 1.5 muaj pagë neto për vjetërsi, sipas nenit 145 të Kodit të Punës;
- Pagën neto për pushimet vjetore të pakryera, sipas nenit 155/3 të Kodit të Punës;
- Si dhe 5 muaj pagë neto për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar.

Ndër të tjera gjykata në dispozitivin e vendimit të saj ka vendosur një afat të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit, duke e detyruar Ministrinë e Mjedisit të derdhë shumën e detyrimit dhe shpenzimet gjyqësore në llogarinë bankare të ankuesit brenda 12 muajve nga dita që vendimi të marrë formë të prerë, në 12 këste mujore të barabarta.

Me vendimin nr. 3510, datë 7.10.2016, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vendosur lënien në fuqi të tij, duke marrë formë të prerë.

Për të mundësuar materializimin e së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore, konstatohet se, pala gjyqfituese, në këtë rast ankuesi, i është drejtuar institucionit tuaj duke kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe dorëzimin e vlerës në të holla, sipas dispozitivit të vendimit. Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit e gjysëm në llogarinë e ankuesit nuk është derdhur asnjë kest, në kundërshtim me detyrimin e vendosur nga gjykata në dispozitivin e vendimit të saj.

Për një zgjidhje të drejtë të kësaj çështje si dhe në përmbushje të detyrimit tonë kushtetues dhe atij ligjor, me shkresën nr. K3/N13-2 prot., datë 27.04.2018 “Kërkesë për shpjegime”, ju jemi drejtuar duke kërkuar shpjegime mbi ankesën e shtetasit Nevruz Petrit. Në përgjigje të kërkesës tone, me shkresën tuaj nr. 3678/1 prot., datë 14.05.2018, na bëni me dijeni se keni njoftuar përmbaruesin gjyqësor se kreditori N.P figuron i regjistruar në databazën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë”, me nr. rendor 39. Duke e konsideruar përgjigjen tuaj të paplotë me shkresën nr.K3/N13-5 prot., datë 30.05.2018 ju jemi drejtuar përsëri duke ju kërkuar të na informoni mbi natyrën e vendimeve gjyqësore që janë në pritje për ekzekutim dhe nëse janë respektuar detyrimet që rrjedhin nga neni 605 i Kodit Civil.

Me shkresën tuaj nr. 4736/1 prot., datë 21.06.2018 na keni kthyer po të njëjtën përgjigje pa ju përgjigjur kërkesës tone, sipas objektit të kërkimit dhe për këtë arsye ju jemi drejtuar përsëri me shkresën K3/N13-8 prot., datë 12.07.2018 duke ju rikërkuar informacion mbi natyrën e vendimeve gjyqësore dhe nëse janë respektuar përcaktimet e nenit 605 të Kodit Civil në hartimin e kësaj liste. Me shkresën tuaj nr. 4736/3 prot., datë 13.08.2018 “Shpjegime” na bëni me dije se vendimi që i përket kreditorit është i renditur me nr. rendor 39 dhe përsa i përket natyrës së vendimeve gjyqësore të rënditura më parë në listë, janë vendime me objekt marrëdhëniet e punës.

Pas marrjes së të gjithë informacionit të kërkuar dhe vlerësimit të dokumentacionit të depozituar nga ankuesi, konstatojmë se edhe pse kanë kaluar përreth 2 vjet nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor të lartpërmendur, nuk është bërë dhe nuk po bëhet e mundur respektimi i së drejtës së ankuesit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, fituar prej tij në rrugë gjyqësore. Në zbatim të detyrimeve ligjore, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor civil të formës së prerë por pa rezultat.

Qëndrimin tuaj në lidhje me procesin e ekzekutimit të vendimit sa më sipër, e vlerësojmë të parregullt dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore të cilat parashikojnë ekzekutimin e titujve ekzekutiv.

Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk ekziston asnjë shkak apo pengesë në ekzekutimin e plotë të detyrimit për pagimin e detyrimit në favor të gjyqfituesit, sipas urdhërimeve të gjykatës, duke programuar paraprakisht fondet përkatëse. Ju bëjmë me dije se nga mosekzekutimi në kohë të detyrimit, palës ankuese i lind e drejta për përfitimin

e interesave për vonesën në ekzekutim, çka do të sillte rritjen e detyrimit tuaj në dëm të buxhetit të shtetit dhe për rrjedhojë në dëm të takaspagueve shqiptarë. Nëse përsëriten raste të tilla, do jemi në kushtet ku do të kërkojmë marrjen e masave të tjera, këtë here po mjaftohemi me tërheqjen e vëmendjes ndaj personave përgjegjës.

Gjithashtu, mosrespektimi i së drejtës të ankuesit brenda afatit ligjor, nuk i shërben rritjes dhe përmirësimit të standarteve të shtetit ligjor, pasi ai ndikon në mosfinalizimin e procesit të dhënies së drejtësisë, dhe sikundër kuptohet edhe nga ankesa e mësipërme, ul autoritetin e institucionit dhe krijon premisa për humbjen e besimit ndaj dhënies së drejtësisë, duke çenuar të drejtat dhe liritë e shtetasve të mbrojtura nga Kushtetuta dhe Ligjet.

Në kushtet e mospërbushjes së detyrimit në afatin e vendosur nga Gjykata, ndodhemi përpara cënimit të parimit për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, sikundër sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore,

Qëndrimi i mbajtur nga institucioni juaj nuk vjen në përputhje me parashikimet e nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ku përcaktohet se : *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*, apo nenin 451/a të K.Pr.C: *“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera...”* dhe as me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e Organeve të Administratës Publike, të sanksionuara në K.Pr.A. dhe të detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Asnjë argument i përdorur nga institucioni juaj, nuk mund të justifikojë moszekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqësore. Ju kujtojmë se në vendimin e datës 18.11.2004, të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pas shqyrtimit të çështjes ankimore të ushtruar nga kreditori, firma e ndërtimit “Qufaj”sh.p.k, për moszekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia, Tiranë, nënvizon se : *“Asgjë, as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mos ekzekutimin e një vendimi gjyqësor”*. Ka qënë dhe është detyrim i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit marrja e masave për përbushjen e detyrimit, sipas përcaktimeve të dispozitivit të vendimit të sipërcituar.

Gjykata kushtetuese në praktikën e saj kushtetuese shprehet se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ-së. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Insitucioni juaj nuk mund të përmend mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës, aq më shumë që gjykata ka vendosur në mënyrë taksative në dispozitivin e saj, ekzekutimin e vendimit brenda 12 muajve nga marrja e tij formë të prerë dhe me këste. Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj gjyqësore është shprehur vazhdimisht se mungesa e fondeve nuk përbën argument për të justifikuar moszekutimin e vendimit gjyqësor.

Gjithashtu edhe Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në praktikën e saj të vazhdueshme ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë.

Parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj.

Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre.

Insitacioni juaj nuk mund të justifikohet me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqet me të gjitha mjetet dhe mundësitë që keni në dispozicion për ta zbatuar atë.

Duhet të kishit marrë të gjitha masat e nevojshme dhe duhet të gjeni mjetin e përshtatshëm ligjor për vënien në dispozicion të ankuesit dëmshpërblimin financiar, si një detyrim ligjor, i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë përbën titull ekzekutiv.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se ankuesi Nevruz Petriti e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Prosesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Nga aktet e depozituara pranë institucionit të Avoktit të Popullit rezulton se ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Korçë që në datën 17.09.2014 dhe tashmë kanë kaluar 4 vite. Nëse ky proces do të vazhdojë akoma të zvarritet më tej humbet sensin rivendosja e së drejtës së shkelur, nëpërmjet vendimit të gjykatës dhe ky proces nuk mund të zgjasë pafun.

Ndodhur në këto kushte, Avokati i Popullit nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problem, vlerëson tju drejtohet me këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit.

Sa më sipër, në zbatim të përcaktimeve të Nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të*

propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar. “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëherëshme për ekzekutimin e detyrimit të vendosur nga vendimi Gjyqësor Civil i formës së prerë Nr.632, datë 07.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Korçë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI

*Konc: Suzana Cena
Date: 03.01.2019*